



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale  
Mbledhja nr. 43  
Prishtinë, 09 qershor 2009, në orën 11: 00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Teuta Hadri, Flora Brovina, Gjylnaze Sylja, Armend Zemaj, Bujar Bukoshi dhe Nurishahe Hulaj.

Munguan: Slllobodan Petroviq, Mimoza Ahmetaj dhe Qamile Morina.

Të ftuar: Përfaqësues të mjekëve specialistë të biokimisë klinike: dr. Shemsi Veseli, dr. Zana Baruti dhe dr. Driton Avdiu.

Mungoi: Fehmi Podvorica - përfaqësues i Komisionit Qeveritar për çështjen e licencimit të studentëve të biologjisë.

Të pranishëm: Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore dhe Fatime Qorri - zyrtare ligjore; nga NDI-ja: Avni Zuka dhe nga Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës: Nexhat Shatri.

Mbledhjen e kryesoi: Sadik Idriz - kryetar i Komisionit.

Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

**Rend dite**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 3. Shqyrtimi i shkresës së mjekëve specialistë të biokimisë klinike;**
- 4. Diskutimi për realizimin e Planit të punës të Komisionit;**
- 5. Të ndryshme.**

*Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

*Kryesuesi konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa ndryshime.*

## 3. Shqyrtimi i shkresës së mjekëve specialistë të biokimisë klinike

**Sadik Idriz** – Tha se Komisioni e ka marrë një shkresë nga mjekët specialistë të biokimisë aplikative, me të cilën kundërshtojnë vendimin e Qeverisë për çështjen e licencimit të studentëve të biologjisë. Për ta shqyrtuar këtë shkresë Komisioni ka ftuar në këtë takim përfaqësues të Komisionit të Qeverisë dhe përfaqësues të mjekëve specialistë të biokimisë aplikative. Hapi diskutimin.

**Dr. Shemsi Veseli** – Mjekët specialistë të biokimisë klinike e kundërshtojnë vendimin e Qeverisë për çështjen e licencimit të biologëve aplikativë. Ky vendim është i njëanshëm, joobjektiv, është në kundërshtim me Ligjin për shëndetësi, neni 86 pika h. Kjo pikë ka të bëjë me teknikët e përcaktuar mjekësorë sipas listës zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë, - me laborantë dhe me infermierë të shkollës së mesme të mjekësisë, por fare nuk ka të bëjë me drejtimet e biologjisë. Grupi i punës i Qeverisë me qëllim nuk e ka futur asnjë rekomandim, as kriter të paraqitur nga përfaqësuesi i Fakultetit të Mjekësisë, që ka dhënë mendim shkencor për planprogramet dhe *kurikulat* e mësimin në Fakultetin e Mjekësisë - Biologjisë aplikative. Drejtimi master biokimi - fiziologji dallohet shumë për objekt studimi. Për mjekësi objekt studimi është njeriu, ndërsa për biologji objekt studimi janë bimët dhe shtazët. Të diplomuarit e këtyre dy drejtimeve janë kompetentë vetëm për punën jashtë laboratorëve mjekësorë dhe janë në kompetencë të Ministrisë së Arsimit për licencim dhe assesit të Ministrisë së Shëndetësisë. Kërkesa e studentëve të biologjisë aplikative dhe me master biokimi-biologji për t'u licencuar si punonjës shëndetësorë, është kundërshtuar nga Dekanati i Fakultetit të Mjekësisë. Ne kemi laboratorë eksperimentalë, hulumtues dhe të klinikës humane. Këto nuk bënë të përzihen. Licencimi i biologëve aplikativë dhe master biokimi-biologji në laborantë të lartë mjekësorë dhe krijimi i mundësisë që ata të punojnë në laboratorë klinikë me njerëz, do të ishte rrezik i madh, sepse gjatë studimeve nuk e kanë pasur objekt studimi njeriun. Zbatimi i këtij vendimi do të sillte sfida të reja për mjekësinë kosovare. Pa ia mohuar askujt të drejtën për punësim, në bazë të përgatitjes akademike, lejimi i këtyre personave me këtë kualifikim që të punojnë nëpër laboratorët klinikë-humanë, do ta thellonte edhe më shumë kaosin që po mbretëron. Pra, nuk është në interesin e shtetit dhe të Qeverisë që biologët aplikativë të avancohen në punëtorë shëndetësorë profesionistë.

**Rita Hajzeraj** – Tha se është shqetësues fakti që të nxirret një Udhëzim administrativ, i cili nuk ka fare bazë ligjore. Komisioni për Shëndetësi duhet ta japë një rekomandim në mbështetje të kërkesës së mjekëve specialistë të biokimisë klinike. Biologët aplikativë nuk duhet të përjashtohen nga procesi, por duhet të gjenden rrugë të tjera për punësimin e tyre. Komisioni, në radhë të parë, duhet ta mbrojë ligjin. Vendimi i Qeverisë është bazuar në nenin 86, pika h, por ky nen ka të bëjë me laborantët e mjekësisë e jo me biologët aplikativë.

**Teuta Hadri** – Tha se edhe në mbledhjen e kaluar, kur është shqyrtuar kërkesa e mjekëve specialistë, e përkrahu kërkesën, sepse ajo është kundër asaj që biologët aplikativë të punojnë në laboratorët humanë. Me këta (biologët aplikativë), duhet të merren Dekanati dhe Ministria e Shëndetësisë.

**Gjylnaze Syla** – Tha se Komisioni, në radhë të parë, duhet të kujdeset të zbatohet ligji. Së dyti duhet të kujdesemi për shëndetin e njerëzve, pasi dihet se biologët aplikativë nuk kanë të bëjnë me njeriun dhe së treti Komisioni duhet të vendosë si do të jetë rekomandimi që i dërgohet Qeverisë për këtë çështje. Kryeministri është dashur të merrte vendim në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe me Ministrinë e Shëndetësisë.

**Nurishahe Hulaj** – Tha se e kemi detyrë që këta të rinj, që kanë mbaruar fakultetin, të mos i lëmë pa punë. Këto kuadro nuk mund të shndërrohen në personel shëndetësor. Mund të jenë bashkëpunëtorë shëndetësorë dhe të punojnë në paraklinikë, por jo në klinikë. Nuk duhet t'i refuzojmë, por duhet të gjejmë modalitete që edhe të rinjve, që kanë kryer master biokimi-fiziologji, t'u gjenden vende, në departamente paraklinike, në të cilat mund të punësohen si bashkëpunëtorë shëndetësorë. Ligji për shëndetësi është në procedurën e plotësimit e të ndryshimit. Do të gjendet edhe formë ligjore për t'i ndihmuar këto kuadro për punësim.

**Bujar Bukoshi** - Tha se Komisioni edhe para këtij takimi ka shqyrtuar kërkesën e mjekëve specialistë të biokimisë klinike. Tha se është skandalizuar me propozimin e Komisionit për çështjen e licencimit të biologëve klinikë dhe me vendimin arbitrar të kryeministrit. Duhet ta mbrojmë, në radhë të parë, shëndetin e qytetarëve. Komisioni duhet t'i respektojë procedurat dhe t'i rekomandojë kryeministrit ta tërheqë këtë vendim.

**Flora Brovina** – Përderisa Ministria e Arsimit bazë e ka sistemin e “*Bolonjës*“, Ministria e Shëndetësisë nuk e njeh këtë sistem. Këto kuadro janë biologë aplikativë, jo biologë. Ata mund të punësohen në parashëndetësi. Në shtetet e tjera sistemi i “*Bolonjës*” funksionon ndryshe. Prej vitit të parë fillon specializimi për këtë degë. Kanë më shumë lëndë dhe kualifikohen pikërisht për këtë degë. Pajtohet me mendimin se planprogramet ndryshojnë. Kjo është dashur të merrej parasysh nga Komisioni, i cili ka vendosur për këtë çështje.

**Armend Zemaj** – Tha se të rinjtë nuk janë fajtorë nëse dikush e ka bërë një ligj për një arsimim, i cili krijon probleme për punësim. Edhe pse nuk kam informata se kush ka qenë në grupin ndërministror të punës, në këtë takim u përmendën: Rektorati, Ministria e Arsimit dhe Ministria e Shëndetësisë. E pakuptimtë është pika 2 e vendimit, në të cilin bëhet fjalë: cili do të ishte aftësim shtesë. Komisioni mund ta bëjë një rekomandim. Kontributin kryesor për zgjidhjen e kësaj çështjeje mund ta japin mjekët specialistë të biokimisë klinike në bashkëpunim me Fakultetin e Mjekësisë, me Ministrinë e Arsimit dhe me Ministrinë e Shëndetësisë. Në bazë të kësaj që kam para vetes, duke pasur parasysh interesin e brezave të rinj, vendimi që vjen nga kryeministri, i propozuar nga një grup ndërministror përgjegjës për të bërë punë profesionale dhe sipas asaj që u paraqit nga mjekët specialistë të biokimisë klinike, personalisht nuk mund të marrë vendim “*për*” as “*kundër*”. Propozoi të ftohen menjëherë përfaqësuesit e këtij grupi ndërministror, konkretisht të Ministrisë së Arsimit dhe të Ministrisë së Shëndetësisë. Të rinjtë kanë të drejtë t'i kërkojnë të drejtat që u janë premtuar me ligj për një sistem të tillë të shkollimit.

*Pas diskutimeve të deputetëve Komisioni nxori këtë*

#### *Përfundim*

*Shkresa e mjekëve specialistë të biokimisë klinike do të shqyrtohet edhe në mbledhjen e radhës. Komisioni do të nxjerrë rekomandim përkatës për këtë çështje.*

#### **4. Diskutim për realizimin e Planit të punës të Komisionit**

**Sadik Idriz** – Tha se Komisioni për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale nuk ka ngecje në realizimin e Planit të punës. Ngecjet kanë të bëjnë me ligjet e parapara në strategjinë legjislative të Qeverisë, por që nuk janë proceduar për shqyrtim në Kuvend. Hapi diskutimin.

**Nurishahe Hulaj** – Propozoi që Komisioni t'i drejtohet me një rekomandim Kryesisë së Kuvendit dhe të kërkojë nga Qeveria procedimin e ligjeve të parapara në strategjinë legjislative, mbi bazën e të cilave janë përgatitur Plani i Kuvendit dhe Plani i punës të komisionit.

*Pas diskutimeve të deputetëve Komisioni nxori këtë*

#### *Përfundim*

*Komisioni t'i rekomandojë Kryesisë së Kuvendit të kërkojë nga Qeveria e Kosovës, procedimin në Kuvend të ligjeve të parapara me strategjinë legjislative të Qeverisë për vitin 2009.*

#### **5. Të ndryshme**

##### **a) Diskutim për Raportin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për PVPE-në.**

*Kryesuesi konstatoi se Komisioni e miratoi Raportin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për PVPE-në, i cili do t'i procedohet Komisionit për Integritet Evropian.*

##### **b) Diskutim për vizitën e Komisionit në QKUK, mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve dhe për vizitën e Komisionit në fabrikën “New Co – Farmakos”**

**Sadik Idriz** – Propozoi që, më 16 qershor 2009, Komisioni të vizitojë QKUK-në dhe të njoftohet për së afërmi për gjendjen.

**Gjylnaze Syla** – Propozoi që Komisioni të dalë në terren t'i shohë vështirësitë e Inspektoratit të Punës.

**Sadik Idriz** – Propozoi që Komisioni ta fillojë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin e Punës.

**Teuta Hadri** – Propozoi që Komisioni ta mbikëqyrë zbatimin e Ligjit për duhanin.

**Rita Hajzeraj** – I njoftoi anëtarët e Komisionit se pronari i fabrikës “New Co Farmakos” e ka ftuar për vizitë në këtë fabrikë Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Pas diskutimeve të deputetëve Komisioni nxori këtë

*Përfundim*

- *Komisioni më 16 qershor 2009 do të vizitojë QKUK-në;*
- *Komisioni do të fillojë ta mbikëqyrë zbatimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës. Grupi i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji do të formohet në mbledhjen e radhës;*
- *Komisioni në një nga mbledhjet e radhës do të vendosë ta vizitojë fabrikën “New Co-Farmakos”.*

Mbledhja përfundoi në orën 12:20

E hartoi  
Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

---

Sadik Idriz